



EUROPEAN
QUALIFIERS



18:00

**AIR ALBANIA
STADIUM**

SHQIPËRI
VS **ANGLI**

16 NËNTOR 2025


GRUPI K

macron.com

f @ X in



macron



No one was born a hero.

It's an everyday journey.

There are no shortcuts.

No days off.

No perfect scenarios.

Things won't always go

the way you expect.

But overcoming challenges

is part of the game too.

Your time is now.

When passion runs through you,

**BECOME
YOUR OWN
HERO.**



SCAN THE QR CODE
AND DISCOVER MORE
ABOUT MACRON



TË DASHUR TIPOZË KUQEZINJ, MIQ TË FUTBOLLIT DHE MBËSHTETËS TË KOMBËTARES SONË,

Jemi mbledhur sërish së bashku në një moment historik për futbollin shqiptar. Më 13 nëntor, Shqipëria shkroi një faqe të re në rrugëtimin e saj ndërkombëtar, duke siguruar për herë të parë në histori kualifikimin **në fazen play-off të Kupës së Botës 2026**. Fitorja 1-0 ndaj Andorrës ishte shumë më tepër sesa një rezultat sportiv. Ishte një dëshmi e qartë e karakterit, përkushtimit dhe forcës së këtij ekipi.

Ky është një hap i madh përpara, një arritje që vjen si rezultat i punës, disiplinës dhe vizionit të lojtarëve tanë, stafit teknik dhe të gjithë atyre që kontribuojnë çdo ditë që Shqipëria të ecë përpara. Por mbi të gjitha, kjo arritje është edhe e juaja, tifozëve të Kombëtares, të cilët nuk reshtni së besuari, së mbështeturi dhe së qëndruari pranë skuadrës në çdo ndeshje, kudo ku ajo luan.

Sot, ne përballemi me një kundërshtar të madh: **Anglinë**. Një ekip mes më të fortëve në botë, me traditë, me uje dhe me eksperiencë të jashtëzakonshme. Por në "Air Albania", ne jemi gjithmonë Shqipëria, një ekip që luan me zemër, me krenari dhe me motivimin e një populli të tërë pas vetes.

Kjo ndeshje ka rëndësi të madhe, jo vetëm për rrugëtimin tonë sportiv, por edhe për emocionet që sjell për çdo shqiptar, brenda e jashtë kufijve. Është sfida që të gjithë presin, një spektakël futbolli që na jep mundësinë të tregojmë vlerat tona.

Disiplinën, pasionin, korrektësinë dhe dëshirën për të bërë më të mirën.

Ekipi ynë është gati. Lojtarët janë të vendosur, të uritur për sukses dhe të vetëdijshëm për peshën e kësaj ndeshjeje. Ata e kanë treguar se dinë të luftojnë në situatat më të vështira, se dinë të mbajnë ritmin e ekipeve më cilësore dhe se dinë të ngrenë lart emrin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Të dashur tifozë,

Në çdo moment, ju keni qenë forca shtesë e Kombëtares. Stadiumi ynë do të jetë sërish një kështjellë ku mbështetja juaj do të ndihet fort, ku çdo thirrje dhe çdo duartrokitje do t'u japë lojtarëve tanë energjinë e duhur për të përballuar një sfidë kaq të madhe. Por, si gjithmonë, kërkoj nga ju që kjo mbështetje të jetë shembullore: me pasion, me qytetari dhe me respekt për rregullat dhe kundërshtarin. Futbolli është festë, është garë, por mbi të gjitha është kulturë.

Si Federatë, jemi plotësisht të angazhuar që kjo ndeshje të zhvillohet në standardet më të larta të UEFA-s dhe FIFA-s. Dua të falënderoj të gjitha institucionet shtetërore, partnerët tanë dhe të gjithë punonjësit e përfshirë në organizim, që punojnë pa u lodhur për ta bërë këtë mbrëmje të denjë për futbollin shqiptar.

Le të shijojmë sonte këtë ndeshje të madhe, le të besojmë në ekipin tonë dhe le të mbajmë gjallë ëndrrën e madhe kuqezi.

Me respekt dhe krenari,
ARMAND DUKA

President i Federatës Shqiptare të Futbollit

Fundi i një rrugëtimi të suksesshëm



Shqipëria, si kurrë më parë Prek ëndrrën e play-off-it të Botërorit 2026

Futbollistët e ekipit kombëtar kanë vetëm një ëndërr. Të përfaqësojnë ekipin e tyre kombëtar në finale të një kampionati europian apo botëror. Djemtë tanë e kanë provuar Europeanin 2 herë. Jo më një utopi për ta, që po e kthejnë në një zakon të bukur.

Por ëndrra play-off Botërori dukej vërtetë e largët. E paarritshme. Jo sepse skuadra jonë nuk i ka elementët. Përkundrazi, si kurrë më parë kemi një ekip të mirë, me uje boll, nga fusha në pankinë e nga pankina në tribunë. Ka një trajner e staf teknik të mirë që na udhëhoqi me sukses drejt finaleve të Europeanit, një Federatë që i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe një Shqipëri të tërë që e mbështet.

Kombëtarja jonë e nisi jo fort mirë fushatën kualifikuese të Botërorit 2026. Në fakt ishte e pritshme. Përballë Anglisë në "Wembley", askush nuk priste ndonjë mrekulli. Jo se nuk i kishim mundësitë, por ndonjëherë të mundësh historinë, duhet të bëhesh ti historia. Përballja jonë direkte nuk ishte dhe nuk është Anglia. Por Serbia, Letonia e Andorra. Më 7 qershor u përballëm me Serbinë në "Air Albania", një sfidë ku skuadra luajti sikur në fushë të ishin të gjithë lojtarët e grumbulluar dhe jo vetëm 11. Pavarësisht barazimit. Penalltia e humbur nga Rey Manaj (45+1) ishte kryefjala e mbrëmjes dhe jo rezultati 0-0. Tre ditë më vonë, barazimi 1-1 në Letoni dukej si fundi i një ëndrre që sapo kishte nisur.

Në fakt ishte vetëm qetësia përpara stuhisë. Më 10 shtator kuqezinjtë rigjetën "dritën", falë fitores 1-0 kundër Letonisë në "Air Albania". Dhe pastaj, mrekullia e 11 tetorit në Leskovac kundër Serbisë. Rey Manaj foli me gjuhën e Zotit, duke shënuar pikërisht në minutën 45+1, në të njëjtën minutë kur kishte humbur penalltinë në Tiranë. Rastësi apo shenjë nga zoti që Shqipëria meriton fazën e play-off?

Më 28 nëntor 1912, Ismail Qemali ngriti flamurin në Vlorë, duke shpallur pavarësinë e Shqipërisë. Ky ishte nëntori i dytë për vendin tonë, pas 28 nëntorit të vitit 1443 ku heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti me forcat e tij çliroi Krujë dhe ngriti flamurin kuq e zi. Por tashmë mund të themi me plot gojë se nëntori i tretë po shkruhet në stadione nga Kombëtarja shqiptare, me kualifikimet në finale të Europeanit apo tashmë në play-off-in e një Kampionati Botëror.

Fitorja ndaj Andorrës dhe ngecja e Serbisë kundër Anglisë në "Wembley" vulosi fatin e skuadrave në grupin K. Shqipëria siguron vendin e dytë në grup dhe prek ëndrrën play-off për herë të parë në histori. Sonte shqiptarët kanë të drejtë të festojnë. Pavarësisht rezultatit. Yjet e Europës zbresin në fushën e "Air Albania" ndërsa ne fluturojmë drejt Botërorit 2026. Edhe pak kanë mbetur. Edhe dy ndeshje...

KALENDARI I NDESHJEVE TË SHQIPËRISË

ANGLI		2-0	SHQIPËRI
21 MARS 2025 / WEMBLEY / 20:45			
SHQIPËRI		3-0	ANDORRA
24 MARS 2025 / 20:45			
SHQIPËRI		0-0	SERBI
7 QERSHOR 2025 / 20:45			
LETONI		1-1	SHQIPËRI
10 QERSHOR 2025 / 20:45			
SHQIPËRI		1-0	LETONI
9 SHTATOR 2025 / 20:45			
SERBI		0-1	SHQIPËRI
11 TETOR 2025 / 20:45			
ANDORRA		0-1	SHQIPËRI
13 NENTOR 2025 / 20:45			
SHQIPËRI		VS	ANGLI
16 NENTOR 2025 / 18:00			



Mbrojtje e PLOTË për makinën tuaj

Një makinë e siguruar është një hap i sigurt për të udhëtuar pa brenga. Me sigurimin KASKO, ju përfitoni:

- ✓ Mbrojtje nga dëmet aksidentale
- ✓ Dëmtimet nga zjarri, rrufeja, shpërthimi
- ✓ Mbrojtje nga ngjarje natyrore
- ✓ Vjedhja

Sigurimi
KASKO
i makinës
vetëm tek
SIGAL





Shqipëria do të presë Anglinë në ndeshjen e vlefshme për Eliminatoret e Botërorit 2026, Grupi K, më 16 nëntor në ora 18:00 stadiumin “Air Albania” të Tiranës. Kjo do të jetë ndeshja e dytë e kësaj fushate kualifikuese, ndërkohë që të dyja kombëtalet janë përballur 7 herë në të kaluarën. Që të shtata sfidat kanë qenë zyrtare dhe të shtata kanë qenë të vlefshme për eliminoret e Botërorit.

* * *

Shqipëria dhe Anglia kanë luajtur ndeshjen e parë midis tyre më 8 mars të vitit 1989. Për herë të parë jemi përballë në eliminoret e Botërorit “Itali 1990”. Kombëtarja kuqezi, që atëherë drejtohej nga Shyqyri Rreli, ndeshjen e parë e luajti në fushën e saj.

Ndeshja e luajtur në stadiumin “Qemal Stafa” në praninë e më shumë se 25 mijë tifozëve do të mbyllet me fitoren e Anglisë 0-2. Vendosën golat e John Barnes në minutën e 16-të të sfidës dhe i Bryan Robson në minutën e 63-të. Shqipëria vinte në këtë duel me formacionin më të mirë të saj.

Në portë Mersini, në mbrojtje Zmijani, Hodja, Artur Lekbello, në mesfushë Gega, Jera, Josa, Murati dhe në sulm Millo, Demollari e Minga. Ka qenë një ndeshje e luajtur në një atmosferë elektrizuese dhe e shumëpritur për tifozët kuqezi, të cilët kishin mbushur plot e përplot stadiumin. Interesi i medias së huaj ka qenë shumë i madh në një kohë që Anglia vinte në këtë sfidë me lojtarë të kalibrit botëror e që luanin me klubet më të famshme në Europë. Në numrin e marsit të vitit 1989, në prag të ndeshjes që Anglia do të zhvillonte në Tiranë, revista e mirënjohur “World Soccer” do t’i dedikonte një shkrim kombëtares së Shqipërisë.

GJITHÇKA DUHET TË DINI PËR HISTORIKUN e 7 dueleve zyrtare me “tre luanët”





Ndeshja e kthimit u luajt më 26 prill 1989 në Londër. Në stadiumin e famshëm "Wembley", kombëtarja u mund me rezultatin 5-0, por ajo sfidë mbahet mend për golin që i mohuan Sulejman Demollarit, që mbetet një mister i madh edhe sot e kësaj dite dhe mund të kishte ndryshuar rrjedhën e sfidës. Legjenda e futbollit shqiptar realizoi me një kthesë të shkëlqyer nga jashtë zone me të majtën, duke heshtur të gjithë stadiumin, mirëpo për çudinë e të gjithëve gjyqtari vendosi ta anulojë. Ishte fundi i pjesës së parë dhe ndeshja ishte në shifrat 2-0 për Anglinë deri në ato momente. Një gol i kuqezinjve, që po luanin mjaft mirë në ato minuta, sigurisht që mund të kishte sjellë një skenar tjetër për sfidën. Gjithashtu, kjo ndeshje është e veçantë edhe për debutimin në portë të 17-vjeçarit Blendi Nallbani, i cili u kthye në një personazh ato ditë për mediat angleze.

Dy ndeshjet e tjera, ishin ato për eliminatorët e Botërorit "Kore - Japoni 2002". Edhe këto ndeshje të fituara nga anglezët. Ndeshja e Tiranës e luajtur më 28 prill 2001 në stadiumin "Qemal Stafa" mori një vëmendje të veçantë nga shtypi anglez, pasi në delegacionin anglez ndodhej edhe aktori i njohur anglez Pitkini (Norman Wisdom), që ishte mjaft popullore në vendin tonë. Ishullorët triumfuan me rezultatin 3-1, por minutat e fundit ishin mjaft emocionuese.



Miqtë kaluan në avantazh në minutën e 73-të me anë të Michael Owen dhe dyfishuan shifrat me Paul Scholes në minutën e 85-të. Por në minutën e 93-të kuqezinjët realizojnë me anë të Rrakllit, i cili sapo ishte futur në lojë si zëvendësues. Në fakt, sulmuesi kavajas realizoi sërish kur rezultati ishte 1-2 për anglezët, duke barazuar në 2-2, por asistenti dhe më pas arbitri luksemburgas, Hamer, e anuluan golin për pozicion "offside" të Rrakllit, që realisht ishte inekzistent. Ky rast është përdorur si shembull dhe interpretuar më vonë edhe në seminarët e UEFA-s, duke e konsideruar gabim vendimin e arbitrave, pasi goli ishte i rregullt.

Në minutën e 95-të më pas anglezët realizuan edhe golin e tretë me anë të Andreë Cole, duke vulosur shifrat finale në 1-3.

Në ndeshjen e kthimit në Njukasëll, kuqezinjët u mundën me rezultatin 2-0, me golat e realizuar nga Michael Owen (43') dhe Robbie Foëler (88'). Kjo ka qenë edhe ndeshja e fundit zyrtare mes dy kombëtareve, që tashmë vihen përballë pas fiks dy dekadave në një tjetër duel të vlefshëm për eliminatorët e Botërorit 2022.

Takimi i vlefshëm për kualifikueset e Botërorit "Katar 2022" më 28 mars 2021 mes Shqipërisë dhe Anglisë në "Air Albania" luhej në një situatë të pazakontë për shkak të pandemisë së Covid-19. I gjithë stadiumi ishte bosh. Ose më saktë i banuar me reklama, për shkak të mungesës së tifozëve dhe rregullat e vendosura asokohe. Anglezët fituan 0-2 falë golave të shënuar nga Harry Kane në minutën e 38-të dhe Mason Mount në minutën e 63-të.

Ndeshja e kthimit në "Wembley" ishte për t'u harruar për kuqezinjët, të cilët pësuan 5 gola në pjesën e parë. Tripleta e Harry Kane dhe golat e Harry Maguire dhe Jordan Henderson vulosën ndeshjen dhe humbjen tonë kundër tre luanëve. Ishte një humbje e trishtë, duke pasur parasysh edhe faktin se në këto kualifikuese ne u renditëm të tretët me 18 pikë të grumbulluara, si asnjëherë më parë në një fushatë Botërore.

Më 21 mars 2025 luajtëm sfidën e parë hapëse të kualifikueseve të Kampionatit Botëror 2026 kundër Anglisë në "Wembley". Thomas Tuchel debutoi në krye të "Tre Luanëve" me fitoren 2-0 në një stadium ku rreth 20 mijë tifozë nga 80 mijë të pranishëm ishin shqiptarë. Himni shqiptarë dëgjohej në të gjithë stadiumin falë brohoritjeve të shqiptarëve që jetojnë e punojnë sot në Angli. Ndeshja u mbyll me rezultatin 2-0, me gola të shënuar nga Myles Lewis Skelly (20') dhe Harry Kane (77').

Samsonite

YOU ARE THE *JOURNEY*

TIRANË: SAMSONITE STORE - KATI 0 TEG

PRISHTINË: SAMSONITE STORE - KATI -1 ALBI MALL

PRISHTINË: SAMSONITE STORE - KATI 0 PRISHTINA MALL

SAMSONITE - PARTNER ZYRTAR I FSHF-SË

VETËM VITAMINA



DHE PIKË.



Tepelene®





STAFI TEKNIK I KOMBËTARES





Me një kreativitet që nuk njih moshë, ne lëvizim me lehtësinë e një leperi dhe mprehtësinë e një mendjeje strategjike. Mjaft të pjekur për të krijuar histori që zgjasin, por mjaft të çlirët për të parë botën me sy të freskët, çdo ditë!



KARROTA.WTF

SHQIPËRIA



Coach







WELCOME **ALL**

*Sharing the love of the game
across generations*

#FOOTBALL

UEFA



SPONSOR I KOMBËTARES SHQIPTARE

Skano për
më shumë



ANGLIA



Coach

THOMAS
TUCHEL



JAMES
TRAFFORD



DJED
SPENCE



NICO
O'REILLY



DEAN
HENDERSON



JARELL
QUANSAH



MARC
GUEHI



DAN
BURN



TREVOH
CHALOBAH



JORDAN
PICKFORD



JOHN
STONES



EZRI
KONSA



REECE
JAMES



PHIL
FODEN



MORGAN
ROGERS



EBERICHI
EZE



ADAM
WHARTON



JORDAN
HENDERSON



MARCUS
RASHFORD



DECLAN
RICE



JUDE
BELLINGHAM



HARRY
KANE



ELLIOT
ANDERSON



JARROD
BOWEN



BUKAYO
SAKA



JETO ME EMOCION

**TURE KULTURORE
AVENTURA
EMOCIONE TË
PAHARRUESHME**



Zenith Travel nisi aktivitetin në vitin 1992 nga familja Sula, me qëllimin për të ofruar udhëtime të rehatshme dhe të përballueshme. Me kalimin e viteve, kompania u zhvillua në një agjenci të mirëfilltë turistike me qendër në Tiranë, duke zgjeruar shërbimet në udhëtime me avion dhe paketa të personalizuar. Që nga viti 2021, Zenith operon edhe si "Tour Online Operator", duke ofruar të gjithë informacionin dhe rezervimet online.

+355 694000016 info@zenithtravel.al





HISTORIA

shkruhet në Andorra

**SHQIPËRIA SIGURON
FAZËN PLAY-OFF TË
BOTËRORIT DHE ARRIN
PESË FITORE RADHAZI,
NJË REKORD ABSOLUT
NË HISTORINË KUQEZI.**

Mbrëmja e 13 nëntorit do të shkruhet me shkronja të arta në historinë e futbollit shqiptar. Për herë të parë, Shqipëria siguroi pjesëmarrjen në fazën play-off të një kampionati Botëror. Fitorja 1-0 ndaj Andorrës në transfertë, e shoqëruar me humbjen 2-0 të Serbisë në “Wembley”, vulosi matematikisht kualifikimin tonë një ndeshje para mbylljes së kësaj fushate.

Një tjetër arritje historike për futbollin shqiptar, që ashtu si në eliminatorët e Europeanit, arriti të sigurojë objektivin një hap ndeshjes së fundit.

Goli i vetëm i sfidës, shënuar nga Kristjan Asllani, vlejti shumë më tepër se tre pikë. Ai na dha biletën drejt play-off-it. Për këtë arsye, sfida e sotme me Anglinë në “Air Albania” është një ndeshje luksi, një sfidë që duhet shijuar dhe luajtur me synimin për të shtuar edhe një tjetër rezultat pozitiv në serinë e ecurisë sonë mbresëlënëse.

Fitorja ndaj Andorrës shënoi gjithashtu një rekord të ri kuqezi. Pesë fitore radhazi, për herë të parë në historinë e Kombëtares. Kuqezinjtë triumfuan ndaj Gjibraltarit dhe Letonisë në shtator, mposhtën Serbinë dhe Jordaninë në tetor, ndërsa suksesi ndaj Andorrës kompletoi serinë historike.

Historia u shkruajt dy herë në Andorra. Tre pikë vendimtare, një biletë drejt play-off-it dhe vendosja e një rekordi të ri kuqezi.


Jemi të pamposhtur!

30 *pranë* vjet *jush!*





FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT



ZYRTARËT E NDESHJES SHQIPËRI - ANGLI

ROLI	EMËR / MBIEMËR	KOMBËSIA
Arbitër	MARCO GUIDA	Italian
Asistent Arbitër i parë	GIORGIO PERETTI	Italian
Asistent Arbitër i dytë	ALESSIO BERTI	Italian
Arbitër i katërt	SIMONE SOZZA	Italian
VAR	MARCO DI BELLO	Italian
Asistent VAR	VALERIO MARINI	Italian
Vëzhgues UEFA	RUNE PEDERSEN	Norvegjez
Delegat UEFA	ANGELO CHETCUTI	Maltez

KOMBËTARJA NË FUSHË VATANI NË TRIBUNË

Homeland Beer



TË GJITHA SKEDAT
E NDESHJEVE



ANGLI - SHQIPËRI 2-0

GOLAT: Lewis-Skelly 20', Kane 77'

GJYQATAR: Alejandro Hernández (Spanja)

Stadiumi Wembley Stadium, Londër

ANGLI: Pickford (GK), Walker, Konsa, Burn, Lewis-Skelly (James 90'), Rice (Henderson 82'), Jones (Rogers 74'), Foden (Bowen 77'), Bellingham, Rashford (Gordon 74'), Kane.

TRAJNER: Thomas Tuchel

SHQIPËRI: Strakosha (GK) (Kastrati 82'), Balliu, Ajeti, Djimsiti, Aliji, Asllani, Ramadani, Laçi (Pajaziti 78'), Asani (Asani 78'), Bajrami (Broja 63'), Uzuni

TRAJNER: Sylvinho

Shqipëria në kualifikueset e Botërorit 2026



SHQIPËRI - ANDORRA 3-0

GOLAT: Rey Manaj 9', 19', Myrto Uzuni 90'+2

GJYQATAR: Sebastian Gishamer (Austria)

Stadiumi "Air Albania", Tiranë

SHQIPËRI: Strakosha (GK), Balliu, Ajeti, Djimsiti (Kumbulla 67'), Aliji, Asllani, Shehu, Laçi (Pajaziti 75'), Broja (Uzuni 76'), Manaj, Hoxha

TRAJNER: Sylvinho

ANDORRA: Alvarez (GK), Font (Llovera 76'), Garcia, San Nicolas, Cervos (Lopez 87'), Olivera, Garcia, Rubio (Rodrigo 62'), Rebes (Teixeira 62'), Babot, Rosas (Cucu 62')

TRAJNER: Koldo Álvarez



SHQIPËRI - LETONI 1-0

GOLAT: Asllani 25' (p)

GJYQATAR: Damian Sylwestrzak (Poloni)

Stadiumi "Air Albania", Tiranë

SHQIPËRI: Strakosha (GK), Hysaj, Ajeti, Djimsiti, Mitaj, Asllani, Shehu, Laçi (Pajaziti 83'), Bajrami (Hoxha 67'), Broja (Kumbulla 90'+1'), Manaj (Daku 83')

TRAJNER: Sylvinho

LETONI: Zviedris (GK), Melniks (Savalnieks 46'), Cernomordijs, Balodis, Jurkovskis (Regza 86'), Varslavans, Vapne (Saveljevs 61'), Zelenkovs, Ciganikis, Daskevics (Gutkovskis 61'), Sits (Melnis 78')

TRAJNER: Paolo Nicolato



SHQIPËRI - SERBI 0-0

GJYQATAR: Davide Massa (Itali)

Stadiumi "Air Albania", Tiranë

SHQIPËRI: Strakosha (GK), Hysaj, Ajeti, Djimsiti, Mitaj, Asllani, Shehu (Ramadani 85'), Laçi, Hoxha (Bajrami 63'), Broja (Uzuni 75'), Manaj (Daku 63')

TRAJNER: Sylvinho

SERBI: Petrovic (GK), Erakovic, Milenkovic, Pavlovic, Maksimovic (Gudejl 88'), Lukic, Zivkovic (Nedejlkovic 88'), Samardzic (Maksimovic 69'), Terzic (S. Mitrovic 69'), A. Mitrovic (Jovic 69'), Vlahovic

TRAJNER: Dragan Stojković



SERBI - SHQIPËRI 0-1

GOLAT: Rey Manaj 45'+1

GJYQATAR: István Kovács (Rumani)

Stadiumi "Gradski stadion Dubočica", Leskovac

SERBI: Petrovic (GK), Milosavljevic, Veljkovic, Pavlovic, Stankovic (Ilic 84'), Maksimovic (Zukic 75'), Kostic, Zivkovic (S. Mitrovic 63'), Samardzic (Kostov 75'), A. Mitrovic (Lovic 63'), Vlahovic

TRAJNER: Dragan Stojković

SHQIPËRI: Strakosha (GK), Hysaj, Ajeti, Djimsiti, Mitaj, Asllani, Shehu, Laçi (Bajrami 78'), Uzuni (Mihaj 90'+3'), Broja (Hoxha 63'), Manaj (Daku 78')

TRAJNER: Sylvinho



LETONI - SHQIPËRI 1-1

GOLAT: Černomordijs 29' (og), Černomordijs 45'+4

GJYQATAR: Umut Meler (Turqi)

Stadiumi "Skonto Stadions", Riga

LETONI: Zviedris (GK), Jaunzems, Jurkovskis, Cernomordijs, Balodis, Ciganikis, Varslavans (Tonisevs 90'), Saveljes (Vapne), Zelenkovs, Ikaunieks (Daskevics 75'), Gutkovskis (Regza 75').

TRAJNER: Paolo Nicolato

SHQIPËRI: Strakosha (GK), Balliu, Ismajli, Kumbulla, Mitaj, Asllani, Shehu, Laçi (Bajrami 69'), Hoxha ((Muçi 60'), Broja (Uzuni 82'), Manaj (Daku 82')

TRAJNER: Sylvinho



Andorra - Shqipëri 0-1

GOLAT: Kristjan Asllani 67'

GJYQATAR: Horațiu Feșnic (Rumani)

Stadiumi "Estadi FAF", Encamp

ANDORRA: Alex Ruiz (GK), Font, Llovera, Olivera, San Nicolás (Planes 86'), Izquierdo (Teixeira 69'), Muller (Ferreira 86'), Cervos, Lopez (Moreno 86'), Rosas (Cucu 69')

TRAJNER: Koldo Álvarez

SHQIPËRI: Strakosha (GK), Hysaj, Ajeti, Djimsiti, Mitaj, Asllani, Shehu, Laçi (Bajrami 59'), Hoxha, Broja (Uzuni 59'), Manaj (Manaj 77')

TRAJNER: Sylvinho

Zgjidhja e duhur për dixhitalizimin e biznesit

Vodafone Business Digital+



Vodafone



GigaFibra



Microsoft 365

ULJE DERI NË

30%

FALAS

Suport
i dedikuar



ALBSIG

30%
ULJE
ALBSIG



Karta
e shëndetit
FALAS



Together we can
vodafone
business

Për më shumë informacion vizitoni <https://www.vodafone.al/biznesi/>